



**Republika e Kosovës/
Republika Kosova / Republic of Kosovo**
Fondi i Sigurimit Shëndetësor / Fond za Zdravstveno Osiguranje /
Health Insurance Fund

**RAPORT
TREMUIJOR I PUNËS
TETOR – DHJETOR 2019**

Prishtinë, janar 2020

Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit	3
1 Hyrje.....	5
2 Realizimi i Buxhetit për periudhën tremujore TM4/2019	6
3 Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve.....	10
4 Sistemi i Informimit të Fondit (SIF)	15
5 Shërbimet Farmaceutike	17
6 Objektivat dhe realizimi i tyre për TM4/2019.....	18
7 Shtojca I. Nën-aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara në TM4.....	26
8 Shtojca II. Nën-aktivitetet e planifikuara në TM3 e të realizuara në fund të TM4	28
9 Shtojca III. Nën-aktivitetet e planifikuara në TM2 e të realizuara në fund të TM4.....	32
10 Shtojca IV. Nën-aktivitetet e planifikuara në TM1 e të realizuara në fund të TM4	36

Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit

I nderuar Kryesues, të nderuar anëtarë të Bordit Drejtues,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush Raportin e Punës për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (më tutje Fondi) për periudhën tremujore tetor – dhjetor 2019 (më tutje TM-4).

Ky raport ofron informata mbi aktivitetet e zhvilluara nga institucioni jonë si dhe mënyrën e shfrytëzimit të burimeve të besuara për këtë periudhë.

Plani i Punës i rishikuar për vitin 2019 përbëhet nga 13 objektiva, 46 aktivitete dhe 148 nën-aktivitete. Prej tyre, në kuadër të TM-4 të këtij viti janë paraparë 39¹ nën-aktivitete.

Përkundër sfidave të hasura në këtë, unë jam i kënaqur të raportoj realizimin e një përqindje të mirë të objektivave (nën-aktiviteteve), përfshirë edhe ato në proces brenda TM4 të këtij viti, në 77%.

Përpos objektivave (nën-aktiviteteve) të realizuara të TM4, brenda kësaj periudhe janë realizuar edhe disa nën-aktivitete të TM2 dhe TM3 të këtij viti, përkatësisht rritjes së realizimit të nën-aktiviteteve të TM2 nga 88% në 97% (Ref: shtojca III), si dhe realizimit të nën-aktiviteteve të TM3 nga 72% në 85% (Ref: shtojca II).

Duke pasur parasysh rëndësinë e realizimit të këtij plani, brenda institucionit kemi krijuar një kulturë të orientuar drejt rezultateve. Më tutje, ne kemi instaluar një mekanizëm i cili monitoron dhe mbikëqyrë ngushtë zbatimin e tij, si dhe për secilin tremujor ne do të raportojmë para jush për të prezantuar sukseset e arritura brenda periudhës raportuese, ngecjet aktuale, si dhe sfidat që mund të na presin në të ardhmen e afërt.

Gjatë periudhës raportuese ne kemi siguruar një qeverisje efektive, kemi siguruar transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha proceset.

Gjatë kësaj periudhe kemi përmirësuar dukshëm proceset e trajtimeve mjekësore, kemi plotësuar numrin e pacienteve për trajtim mjekësor falas sipas marrëveshjes me Turqinë në 100 (megjithëse një numër i pacienteve për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të shkojnë për trajtim shëndetësor), si dhe kemi arritur të barazojmë 13 institucione shëndetësore private në të cilat janë identifikuar 383,222€ të lira. Përpos tyre, ne jemi në proces të barazimeve edhe më 24 institucione tjera shëndetësore private me të cilat kishim 3,451 transaksione.

Kanë vazhduar aktivitetet e planifikuara për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve të TI-së për funksionim sa më efikas drejt kryerjes së shërbimeve. Në këtë tremujor është nënshkruar marrëveshja për shkëmbimin e të dhënave në mes të sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Bankës Qendrore të Kosovës, kurse është në shqyrtim edhe marrëveshja në mes të Fondit dhe Odës së Mjekëve të Kosovës. Për këto institucione janë përgatitur edhe Procedurat Standarde të Operimit, si dhe është vazhduar me mirëmbajtjen e të gjitha ndërlydhjeve që janë realizuar me institucionet relevante.

¹ Ne, nuk mund të bëjmë një prerje të saktë në mes të tremujoreve sepse disa nën-aktivitete sipas planit vjetor përfshihen në dy (2) ose më shumë tremujor.

Gjatë këtij tremujori janë përgatitur dhe konfiguruar ambientet testuese dhe ambientet “production” dhe pas testimit dhe pranimit operacional janë instaluar E-receta dhe Sistemi i Informimit të Fondit (SIF) në këto ambiente. Departamenti i TI-së ka asistuar në të gjitha testimet e SIF-it dhe ka lehtësuar proceset dhe përgatitjen e infrastrukturës teknike për vendosjen dhe instalimin e sistemit bazë. Në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, janë kryer testimet dhe janë publikuar online tri nënsisteme të E-recetës (Web aplikacioni bazë, Portali i pacientit dhe Portali për farmacitë e regjistruara.

Më tutje, janë mbajtur trajnime për 903 farmacistë dhe stafin tjetër të Fondit, siç janë zyrtarët e shërbimeve mjekësore, zyrtarët e buxhetit dhe financave etj.

Lidhur me lokacionin e Fondit është hartuar plani ideor për objektin e Fondit dhe në vitin 2020 pritet të fillohet me kontraktimin dhe ndërtimin e vrazhdët.

Me gjithë të arriturat e potencuara më lart, ne kemi pasur edhe disa sfida në realizimin e objektivave përfshirë plotësimin e parakushteve për kontraktimin e shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premiumeve, përgatitjen dhe finalizimin e listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguhen nga Fondi, si dhe komunikimit me publikun qoftë përmes kampanjave informuese ose formave tjera më qëllim të rritjes së besimit nga ana e publikut.

Objektivat/aktivitetet e pa realizuara janë planifikuar të realizohen në vitin 2020 (Plani vjetor i punës për vitin 2020).

Ne vijim paraqesim raportin me informata më të detajuara për rezultatet e arritura në kuadër të TM4 të këtij viti në raport me objektivat, aktivitetet dhe nën-aktivitetet e përcaktuara në planin vjetor të rishikuar të punës për vitin 2019.

Me respekt,

Fatmir Plaqiqi

Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

Prishtinë, janar 2020

1 Hyrje

Bordi Drejtues i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore ka miratuar Planin e Punës për vitin 2019 më 13 shkurt 2019, i cili në mënyrë të strukturuar paraqet objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara për plotësimin e parakushteve për funksionalizimin e plotë të Fondit, i përcaktuar me Ligjin 04L/249 për Sigurimin Shëndetësor.

Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, përfshirë burimet njerëzore dhe ato financiare.

Plani fillestar i punës për vitin 2019 ka paraparë 14 objektiva, 51 aktivitete dhe 170 nën-aktivitete, mirëpo pas rishikimit të tij më datë 11/09/2019 plani i punës është reduktuar në 13 objektiva, 46 aktivitete dhe 148 nën-aktivitete.

Megjithatë, disa nga aktivitetet e planifikuara nuk janë realizuar për shkak të vonesave në përcaktimin e bazës ligjore (plotësim/ndryshimin e Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore), ose për shkak të mungesës stafit.

Realizimi i këtij plani do të kontribuojë në realizimin e qëllimit kryesor të funksionit të Fondit, *“Sigurimi i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor”*.

Duke pasur parasysh rëndësinë e realizimit të këtij plani, Drejtori i Fondit ka instaluar një mekanizëm i cili monitoron dhe mbikëqyrë ngushtë zbatimin dhe realizimin e tij, si dhe raporton në baza tremujore para Bordit Drejtues për të prezantuar sukseset në realizimin e planit, ngecjet aktuale, si dhe sfidat që mund ta presin Fondin në të ardhmen e afërt.

Nga gjithsej nën-aktivitetet e planifikuara, 39 prej tyre janë të planifikuara në kuadër të periudhës tremujore TM-4.

Buxheti i shpenzuar në kuadër të këtij tremujori ishte 3,476,814€ ose 36% e buxhetit final.

2 Realizimi i Buxhetit për periudhën tremujore TM4/2019

2.1. Buxheti

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Fondit i janë ndarë 8,697,583€.

Tabela 1. Buxheti fillestar i Fondin për vitin 2019

Shpenzimet / Departamentet	Administrata	Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2019
Pagat dhe mëditjet	641,286		641,286
Mallrat dhe Shërbimet	1,060,137		1,060,137
Shpenzimet komunale	66,160		66,160
Subvencionet dhe transferet		6,000,000	6,000,000
Shpenzimet kapitale	930,000		930,000
Gjithsej buxheti për vitin 2019	2,697,583	6,000,000	8,697,583

Nga Tabela nr. 1 mund të shohim se nga gjithsej buxheti fillestar për vitin 2019 në vlerë 8,697,583€, vlera prej 6,000,000€, ose 69% e totalit të buxhetit, ishte ndarë për subvencione dhe transfere (programi - trajtime mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore), ndërsa pjesa tjetër për shërbimet administrative të Fondit.

Buxheti i ndarë për vitin 2019 për trajtime mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore në shumën 6 mil€ nuk mbulonte as obligimet e mbetura në fund të vitit 2018 për këtë program, të cilat ishin 7,170,229€.

Kjo ka paraqitur sfidë për Fondin sepse për çdo vit kalendarik për trajtime jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore aplikojnë rreth 1,500 pacientë dhe mesatarja e shpenzimeve vjetore është afro 12 mil€. Andaj obligimet e mbetura janë duke u rritur nga viti në vit.

Megjithatë pas vendimeve të qeverisë: Nr.01/113 të datës 05.11.2019, si dhe Nr.01/115 të datës 17.12.2019, Fondi kishte kursime buxhetore në vlerë totale 1,856,326€ (paga dhe mëditje në vlerë 283,326€, mallra dhe Shërbime në vlerë 700,000€, komunalitë në vlerë 30,000€, si dhe kapitale në vlerë 840,000€).

Ndërsa, po me të njëjtat vendime, Fondi ka përfituar 2,700,000€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, përkatësisht në programin e trajtimeve mjekësore jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Pas ndryshimeve buxhetore me vendimet e Qeverisë, buxheti i Fondit është rritur për 846,674€. Buxheti final pas ndryshimeve është prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 1. Buxheti final i Fondin për vitin 2019

Shpenzimet / Departamentet	Administrata	Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2019
Pagat dhe mëditjet	357,960		357,960
Mallrat dhe Shërbimet	360,137		360,137
Shpenzimet komunale	36,160		36,160
Subvencionet dhe transferet		8,700,000	8,700,000
Shpenzimet kapitale	90,000		90,000
Gjithsej buxheti për vitin 2019	844,257	8,700,000	9,544,257

2.2. Shpenzimet


Tabela 2. Shpenzimet tremujore TM4/2019 në raport me buxhetin final 2019

Kodi i programit	Programet	Buxheti fillestar	Buxheti i final	Shpenzimet për TM4/2019	Realizimi në %
11324	Paga dhe rroga	641,286	357,960	113,142	32%
	Mallra dhe shërbime	1,060,137	360,137	92,338	26%
	Shpenzimet komunale	66,160	36,160	4,561	13%
	Subvencionet dhe Transferet	6,000,000	8,700,000	3,234,769	37%
71600	Shpenzimet kapitale	930,000	90,000	32,004	36%
Gjithsej		8,697,583	9,544,257	3,476,814	36%

Nga tabela më lart mund të shohim se nga gjithsej buxheti final vetëm në TM4 2019 janë shpenzuar 3,476,814€ ose mbi 36% e buxhetit final. Në vijim është ofruar shpalosje për secilën kategori të shpenzimeve, si:

Në figurën në vijim mund të vërehen shpenzimet për TM4/2019 në raport me buxhetin final për vitin 2019.

Figura 1. Shpenzimet për TM4/2019 në raport me buxhetin final



2.3. Obligimet

Fondi ka krijuar një sistem të mirë të pagesave në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre. Secila faturë e pranuar fillimisht protokollohet dhe paguhet sipas rregullores në fuqi. Për të gjitha faturat e pa paguara mbahet një evidencë e veçantë, të cilat janë raportuar rregullisht në Thesar (Ministrinë e Financave).

Përkundër këtij procesi të rregullt të pagesave, në mungesë të buxhetit një shumë e konsiderueshme e obligimeve kanë mbetur të papaguara. Ato kryesisht lidhen me kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve, përkatësisht programin e Trajtimeve Mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore. Me 31 dhjetor 2019 këto obligime ishin në vlerë 10,508,495€, ose për 1,990,900€ më të ulëta në krahasim me datën 30 shtator 2019, ku vlera e obligimeve ishte 12,499,395€. Në uljen e obligimeve kishin ndikuar edhe pagesat/thyerja e obligimeve me mjetet e lira të identifikuar nga procesi i barazimeve me institucionet shëndetësore private në vlerë prej 363,394€.

Tabela 3. Obligimet më 31 dhjetor 2019

Kategoria Ekonomike	Obligimet me 31 mars 2019	Obligimet me 30 qershor 2019	Obligimet me 30 shtator 2019	Obligimet me 31 dhjetor 2019
Mallra dhe Shërbime	669	984	669	16,586
Shpenzimet Komunale	-	-	-	25
Subvencionet dhe Transferet	9,415,853	11,074,740	12,498,726	10,491,884 ²
Investimet Kapitale	-	-	-	-
Gjithsej	9,416,522	11,075,724	12,499,395	10,508,495

² Në fund të vitit 2019 janë mbuluar të gjitha obligimet e vitit 2018 për subvencione dhe transfere (programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve), me përjashtim të dy faturave në vlerë totale 11,340€ të cilat nuk ishin paguar në mungesë të konfirmimit të llogarive.

Përpos obligimeve të cilat janë të raportuara në Thesar (Ministrinë e Financave), Fondi ka edhe disa detyrime kontingjente.

Gjatë TM4/2019, ndaj Fondit ishin bërë dhjetë (10) ankesa. Nga gjithsej ankesat e shqyrtuara katër (4) janë aprovuar, kurse gjashtë (6) janë refuzuar.

Ngritja e padive është duke rënë në vazhdimësi. Në vitin 2018 kishim 20 padi, në TM1/2019 katër (4) padi, në TM2/2019 dy (2) padi, ndërsa në TM3/2019 dhe TM4/2019 nuk ka asnjë padi.

Ne fund të vitit 2019 janë rishikuar detyrimet kontingjente, përkatësisht janë bartur detyrimet kontingjente për barna në SHSKUK, pasi që në vitin 2019 edhe buxheti për barna është transferuar në SHSKUK. Detyrimet kontingjente pas rishikimit janë të prezantuara në tabelën në vijim.

Tabela 4. Detyrimet kontingjente më 31 dhjetor 2019

Paditësi	Përshkrimi	Vlera
R-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	10,000
B-S	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	2,500
R-I	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	3,878
H-R	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	11,000
A-Q	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	4,800
A-L	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8000
R-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	900
E-H	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	6,000
Sh-T	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	4,000
Xh-H	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	3,000
I-I	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,000
B-A	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,500
D-M	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	2,615
D-M	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,400
S-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	1,400
A-O	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	13,560
H-O	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	9,492
P-D	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	9,500
Gjithsej		115,546

2.4. Pasuritë

Në fund të vitit 2018 është krijuar komisioni për inventarizim të pasurisë i cili pas procesit të identifikimit/numërimit fizik të pasurisë ka hartuar raportin i cili është krahasuar me raportet e pasurisë për të identifikuar dhe eliminuar diferencat.

Më pas, pas aprovimit të ligjit të buxhetit ku Fondi është ndarë si organizatë buxhetore e veçantë është krijuar një komision për transferimin e pasurisë nga Ministria e Shëndetësisë të Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, proces i cili ka përfunduar në TM1/2019 të këtij viti.

Tabela 5. Pasuritë më 31 dhjetor 2019

Përshkrimi	Pasuritë më 31 mars 2019	Pasuritë më 30 qershor 2019	Pasuritë më 30 shtator 2019	Pasuritë më 31 dhjetor 2019
Pajisjet dhe inventari	89,847	150,167	210,517	241,821
Zhvlerësimi për vitin 2019	-	-	-	6,778
Gjithsej	89,847	150,167	210,517	235,043

Në kuadër të TM1, Ministria e Shëndetësisë kishte transferuar në Fond pasurinë në vlerë 89,847€, ndërsa brenda vitit 2019 janë rritur pasuritë për 151,974€, si

- Në kuadër të TM2/2019 Fondi ka rritur pasuritë për 60,320€. Prej tyre 29,800€ për blerjen e automjetit nga granti qeveritar, ndërsa 30,520€³ janë nga huamarrja (pagesat janë bërë nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa pasuria është transferuar në Fond).
- Në kuadër të TM3 prej huamarrjes janë blerë edhe tri (3) automjete në vlerë totale 60,350€; dhe
- Në TM4 është bërë plani ideor për ndërtimin e objektit të Fondit në vlerë 31,304€. Megjithatë, në fund të vitit është bërë edhe zhvlerësimi i pasurisë (6,778€) dhe vlera neto pas zhvlerësimit është 235,043€.

3 Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve

3.1. Trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve

Programi për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur Institucionet Shëndetësore Publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen në institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me udhëzim administrativ në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program si dhe organet për administrimin e programit.

³ PC, lllaptop, pajisje tjera elektronike.

Gjatë TM4/2019 kanë aplikuar 372⁴ paciente për TMJISHP, derisa numri i aprovimeve arrin në 347.

Nëse i shohim në total, aplikimet në raport me aprovimet shohim se kanë mbetur edhe 124 lëndë të pa aprovuara, qoftë për shkak të procedurave administrative ose për shkak të kërkesave për kompletim të dokumentacionit.

Tabela 6. Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për periudhën TM4/2019


Nr.	Përshkrimi	TM1/2019	TM2/2019	TM3/2019	TM4/2019	Total aplikimet TM1 - TM4
1	Aplikime	344	371	349	372	1,436
2	Raste urgjente	147	175	154	152	628
3	Raste të rregullta	197	196	195	220	808
4	Aprovime	214	438	313	347	1,312

Tabela 7. Numri i aplikimeve për trajtimit mjekësor të referuara sipas klinikave për TM4/2019

Nr.	Klinika	Nr. i aplikimeve TM1/2019	Nr. i aplikimeve TM2/2019	Nr. i aplikimeve TM3/2019	Nr. i aplikimeve TM4/2019	Total aplikimet TM1 - TM4
1	Oftalmologji	110	116	80	108	414
2	Pediatri	47	75	60	42	224
3	Ortopedi	32	39	32	32	135
4	Onkologji	18	32	32	26	108
5	Kirurgji torakale	14	17	15	15	61
6	Hematologji	17	9	30	39	95
7	Kardiologji	15	11	9	10	45
8	ORL	12	14	13	13	52
9	Kirurgji abdominale	10	6	2	1	19
10	Urologji	7	8	11	11	37
11	Nenonatologji	7	7	10	12	36
12	Mjekësi nukleare	9	5	6	5	25
13	Neurologji	8	4	7	8	27
14	Kirurgji vaskulare	8	4	8	8	28
15	Nefrologji	8	3	7	3	21
16	Gastroenterologji	8	3	4	8	23
17	Te tjera	14	18	23	31	86
Gjithsej		344	371	349	349	1,436

⁴ Në kuadër të aplikimeve për TM4/2019 përfshihen edhe raste të cilat janë dërguar për trajtim mjekësor falas sipas marrëveshjes me Turqinë. Në marrëveshjen me Turqinë është plotësuar numri i aplikimeve në 100 pacientë, mirëpo një numër i tyre (diku 13 pacientë) për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të shkojnë për trajtim shëndetësor. Ne kemi kërkuar që të zëvendësohen me pacientë të ri, mirëpo kjo nuk është pranuar nga Turqia.

Figura 2. Aplikimet për trajtimit mjekësore të referuara sipas klinikave për TM4/2019



3.2. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve

Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve për TM4/2019 ishin në vlerë 3,234,769€, ose mbi 37% e buxhetit të kësaj kategorie. Në tabelën në vijim janë shpalosur pagesat sipas vendeve ku janë kryer ato.


Tabela 8. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore për TM4/2019

Nr.	Vendi	Numri i pagesave TM1 - TM3	Numri i pagesave TM4	Gjithsej nr. i pagesave TM1 -TM4	Vlera e pagesave TM1 - TM3	Vlera e pagesave TM-4	Vlera e pagesave TM1 -TM4
1	Turqia	159	78	237	3,734,780	1,900,182	5,634,962
2	Kosovë	169	116	285	645,920	565,965	1,211,885
3	Maqedonia	119	62	181	291,627	173,018	464,645
4	Gjermania	25	17	42	273,606	195,860	469,466
5	Shqipëria	47	29	76	240,992	230,239	471,231
6	Italia	12	2	14	132,876	19,150	152,026
7	Austria	6	1	7	52,724	22,089	74,813
8	Anglia	2	-	2	28,132	-	28,132
9	Kroacia	7	4	11	20,747	57,815	78,562
10	Belgjikë	1	-	1	14,015	-	14,015
11	Sloveni	3	1	4	6,200	3,360	9,560
12	Francë	1	1	2	3,093	4,220	7,313
13	Amerikë	-	1	1	-	30,000	30,000
14	Zvicër	-	1	1	-	28,527	28,527
15	Izrael	-	1	1	-	4,345	4,345
Gjithsej		551	314	865	5,444,712	3,234,769	8,679,482

Nga tabela më lart, shihet se për periudhën TM4 të këtij viti janë kryer pagesat për 314 pacientë. Pjesa me e madhe e pagesave janë bërë për të mbuluar të gjitha obligimet e vitit 2018, si dhe disa raste të vitit 2019 të cilat ishin urgjente, ose në rastet tjera kur pacienteve ju ka përkeqësuar gjendja shëndetësore.

Në vijim paraqiten pagesat për trajtime mjekësore për TM4/2019 në formë grafike.

Figura 3. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore për TM4/2019



3.2. Procesi i barazimeve me spitalet private

Me vendimin e datës 23 shkurt 2019, Drejtori i Fondit ka themeluar Komisionin për Barazime Financiare ndërmjet Fondit dhe Institucioneve Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit.

Sipas vendimit, komisioni ka për obligim që të marrë në shikim, kontrollojë, dhe verifikojë tërë dokumentacionin në lidhje me secilën kërkesë individuale për programin TMJIShP, pavarësisht vendit ose kohës së realizimit të kërkesës. Dokumentacioni i pranuar do të verifikohet kundrejt të dhënave dhe informatave që komisioni ka në dispozicion dhe/ose do të pranojë nga ISHP-të brenda dhe jashtë vendit.

Sipas Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 13, Krijimi dhe mbajtja e regjistrave, pika 2. Pavarësisht nga kërkesat për mbajtjen e regjistrave të parashikuara në legjislacionet dhe udhëzimet e tjera administrative tatimore: 12 2.1. një person i cili ka detyrë të krijojë regjistra sipas këtij ligji do t'i mbajë ato regjistra për një periudhë prej së paku **gjashtë (6) vjet** pas përfundimit të periudhës tatimore kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor përkatës.

Bazuar në këtë kërkesë, komisioni i themeluar për barazime ka përcaktuar periudhën 2013 – 2018, përkatësisht gjashtë (6) vite, në të cilën do të bëjë barazimin me spitalet dhe do t'i identifikojë mjetet e lira (rastet në të cilat është kryer pagesa mirëpo nuk janë përfunduar

shërbimet shëndetësore, ose rastet tjera kur shërbimet e ofruara ishin me të ulëta në raport me pagesat).

Procesi i barazimeve ka vijuar sipas hapave të përcaktuar në vijim:

- Përcaktimi i metodologjisë së punës;
- Përgatitja e kartelave me Institucionet Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit;
- Përgatitja e draft barazimeve me Institucionet Shëndetësore Private; dhe
- Përgatitja e raportit final të barazimeve si dhe nënshkrimi nga të dy palët.

Komisioni për barazime fillimisht ka përgatitur metodologjinë e punës përfshirë gjithë procesin nga përgatitja e kartelave e deri të nënshkrimi i raportit si dhe arkivimi i gjithë dokumentacionit. Me pas ka vijuar me përgatitjen e kartelave me secilin Institucion Shëndetësor Private brenda dhe jashtë vendit, si dhe me procesin e barazimeve.

Pasi që vëllimi me i madh i transaksioneve ishte me Institucioneve Shëndetësore Private brenda vendit, komisioni ka vendosur t'i jap prioritet. Në kuadër të tyre, fillimisht janë marrë Institucionet Shëndetësore Private të cilat kanë numrin më të madh të transaksioneve.

Deri me tani janë barazuar 13 institucione me 740 transaksione dhe vlera e mjeteve të lira të dala nga ky proces është 383,222€. Në vijim kemi prezantuar detajet për secilin prej tyre.

Tabela 9. Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi ka përfunduar barazimet

Nr.	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	Klinika Gjermane e Syrit sh.p.k.	288	1,104,286	158,630
2	Qendra Laserike e Syrit - Kubati	341	875,478	197,518
3	Elab Kosova sh.p.k.	37	108,512	5,500
4	Prolab sh.p.k.	14	13,651	260
5	Akat Orthomédica	18	163,450	5,930
6	Tirana Lab	11	10,584	1,504
7	Otrila	4	13,225	2,795
8	Metropolis	1	840	-
9	Qendra Diagnostike Plus	2	765	-
10	CT Scanner	4	8,150	-
11	Italian Medical Center	4	62,409	-
12	Klinika Gjermane DFK	1	4,500	-
13	Ortoprotech	15	62,003	11,085
Total		740	2,427,853	383,222

Përpos 13 Institucioneve Shëndetësore Private të prezantuara në tabelën e lartcekur, komisioni i barazimeve është në proces të barazimeve edhe për 24 institucione të tjera me të cilat Fondi kishte 3,451 transaksione.

Tabela 10. Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi është në proces të barazimeve

Nr.	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave
1	Orthomedica	7	45,890
2	Klinika Amerikane	1	4,700
3	Sinorg	54	835,150
4	Lindja	1	3,500
5	Spitali Amerikan	855	3,994,690
6	Kavaja	101	241,735
7	Royal	164	519,478
8	Rezonanca	181	170,165
9	Eyo Hospital	184	594,694
10	Internacional Medicine Hospital	937	5,667,881
11	Cardio Center Shpk	34	81,700
12	Klinika Gjermane E Syrit Tirane	25	166,100
13	Spitali Amerikan Tirane	236	1,794,384
14	Eye European	149	591,520
15	Acibadem Sistina	181	856,375
16	Zan Mitrev	10	89,590
17	Filip Vtori	61	362,899
18	Remedika	11	29,750
19	Medical Park	55	1,308,049
20	Istinye	2	60,000
21	Acibadem Sistina- Turqi	91	1,025,855
22	Spitali Amerikan - Turqi	36	1,071,549
23	Koc University	18	375,623
24	Liv Hospital	57	2,472,182
Total		3,451	22,363,459

4 Sistemi i Informimit të Fondit (SIF)

Në kuadër të TM4, Departamenti i TI-së ka vazhduar aktivitetet e planifikuara për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve të TI-së për funksionim sa më efikas drejt kryerjes së shërbimeve.

Në këtë tremujor janë përgatitur draftet e marrëveshjeve për shkëmbimin e të dhënave në mes të sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Bankës Qendrore të Kosovës e cila marrëveshje tashmë është nënshkruar, kurse është në shqyrtim edhe marrëveshja në mes të Fondit dhe Odës së Mjekëve të Kosovës. Për këto institucione janë përgatitur edhe Procedurat Standarde të Operimit për shkëmbimin e të dhënave në të cilat specifikohen të dhënat që shkëmbehen, mënyra e shkëmbimit dhe aspekte të tjera teknike.

Është vazhduar me mirëmbajtjen e të gjitha ndërlydhjeve që janë realizuar me institucione të tjera dhe janë përditësuar të dhënat e regjistrave:

- Agjencia e Regjistrimit Civil – ndërlydhja automatike për të dhënat e qytetarëve të Kosovës është funksionale dhe përditësohet në baza ditore;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – ndërlydhja automatike për regjistrin e skemave sociale është funksionale dhe përditësohet në baza mujore;
- Administrata Tatimore e Kosovës – ndërlydhja automatike për pagesat e premieeve është funksionale dhe përditësohet në baza ditore;
- Oda e Farmacistëve të Kosovës – ndërlydhja gjysmë automatike për regjistrin e farmacistëve të licencuar e cila përditësohet në baza periodike sipas nevojës;
- Agjencia për Produkte dhe Pajisje Mjekësore - ndërlydhja automatike për regjistrin e barnatoreve të licencuara është funksionale dhe përditësohet në baza ditore;
- Agjencia për Produkte dhe Pajisje Mjekësore - ndërlydhja automatike për regjistrin e barnave të licencuara funksionale dhe përditësohet në baza ditore, por ende nga AKPPM nuk është përcaktuar kodi unik e barnave; dhe
- Ministria e Shëndetësisë – ndërlydhja gjysmë - automatike për regjistrin e institucioneve dhe personelit mjekësor por të dhënat kanë nevojë të pastrohen dhe të jenë të sakta. Ndërlydhja automatike për vizitën është realizuar, por të dhënat duhet të jenë në sasi dhe cilësi më të lartë.
- Banka Qendrore e Kosovës – janë filluar takimet e para pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe gjatë pjesës së parë të vitit 2020 pritet që të realizohet lidhja për dërgimin e pagesave dhe mbledhjen e premieeve dhe të hyrave të tjera.

Gjatë këtij tremujori është ri-shpallur tenderi për blerjet e pajisjeve harduerike dhe softuerike për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe në TM1 2020 pritet që të bëhet liferimi sipas kontratës.

Është vazhduar popullimi me të dhëna të reja në intranetin e Fondit, por edhe janë mirëmbajtur dhe përditësuar ato ekzistuese, njëkohësisht janë përditësuar informatat në uebfaqen e Fondit dhe janë publikuar dokumente të ndryshme në gjuhët zyrtare.

Në këtë tremujor janë përgatitur dhe konfiguruar ambientet testuese dhe ambienti “production” dhe pas testimit dhe pranimit operacional janë instaluar E-receta dhe Sistemi i Informimit të Fondit (SIF) në këto ambiente. Departamenti i TI-së ka asistuar në të gjitha testimet e SIF-it dhe ka lehtësuar proceset dhe përgatitjen e infrastrukturës teknike për vendosjen dhe instalimin e sistemit bazë. Në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, janë kryer testimet dhe janë publikuar online tri nënsisteme të e-recetës (Web aplikacioni bazë, Portali i pacientit dhe Portali për farmacitë e regjistruara).

Ky departament ka asistuar edhe gjatë mbajtjes së trajnimeve për farmacistë dhe stafin tjetër të Fondit, siç janë zyrtarët e shërbimeve mjekësore, zyrtarët e buxhetit dhe financave etj.

Departamenti ka analizuar të dhënat e regjistrit të qytetarëve të Kosovës dhe ka përgatitur një raport për të gjeturat dhe rekomandimet për përmirësimin e të dhënave që kanë të bëjnë me krijimin e trungut të të siguruarve. Gjithashtu janë analizuar edhe të dhënat e regjistrit të farmacistëve dhe është përgatitur raporti i cili thekson të gjeturat dhe rekomandon përmirësimet që duhet të bëhen në kuadër të këtij regjistri.

Është modifikuar edhe më tutje aplikacioni për kontrollimin e statusit të aplikimit online dhe është publikuar vegëza si nëndomain dhe është lidhur me uebfaqen e Fondit. Po ashtu janë dizajnuar disa raporte sipas kërkesës në aplikacionin e TMJISHP.

Gjithashtu është rekomanduar, konfiguruar dhe është në fazën e testimit platforma për komunikim dhe shkëmbim të dokumenteve me AOK-un gjerman.

5 Shërbimet Farmaceutike

Në kuadër të TM4, Departamenti për Shërbimet Farmaceutike ka realizuar aktivitet e prezantuara si në vijim:

- Pjesëmarrje aktive në Komisionin për përcaktimin e çmimeve të produkteve të regjistruara në Kosovë (pjesa e Barnave – Komision i formuar me Vendim të Ministrit të Shëndetësisë);
- Pjesëmarrje aktive në strukturimin/unifikimin e produkteve të regjistruara në sistemin “Barnatari” të AKPPM-së (Komision i formuar me Vendim të Ministrit të Shëndetësisë);
- Pjesë e ekipit menaxhues të kontratës “Outpatient Drug Benefit Scheme”. Trajnime të vazhdueshme lidhur me metodologjinë e përcaktimit të çmimeve “External and Internal Reference Pricing” nga kompania kontraktuese Conseil Sante; dhe
- Pjesë e ekipit mbështetës për hartimin/implementimin e modulit të e-Recetës; Pjesëmarrje aktive në trajnimin e 903 Farmacistëve lidhur me përdorimin e modulit të e-Recetës.

6 Objektivat dhe realizimi i tyre për TM4/2019

Plani i Punës i rishikuar për vitin 2019 ka paraparë 13 objektiva, 46 aktivitete dhe 148 nën-aktivitete. Prej tyre 39 nën-aktivitete janë planifikuar në TM4 të këtij viti. Prej tyre janë realizuar 30 nën-aktivitete, ose 77% e planit për këtë tremujor. Megjithëse, gjatë këtij tremujori janë realizuar edhe disa nën-aktivitete nga TM2, përkatësisht nga 88% në 97%, si dhe në TM3 nga 72% në 85%. Në vijim janë shpalosur në detaje rezultatet e arritura në raport me objektivat e përcaktuara.

Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparenca dhe llogaridhënia

Në kuadër të kësaj objektive janë paraparë një sërë aktivitete të cilat synojnë që Fondi të udhëhiqet mbi bazat e një qeverisjeje efikase, transparente dhe llogaridhënëse.

Në kuadër të këtij objektivi janë paraparë shumë aktivitete që synojnë efikasitet institucional duke përfshirë identifikimin e rreziqeve si një prej parakushteve për një funksionalizim të qëndrueshëm institucional, mandej raporte të rregullta të auditimit të brendshëm, raportime të rregullta mujore mbi gjendjen financiare si dhe raporti vjetor i Fondit i cili do të pasqyrojë gjitha aktivitetet duke siguruar transparencën e plotë. Këto aktivitete janë:

- 1.1 Përgatitja e një regjistri të rreziqeve të mundshme si dhe menaxhimi i efektiv i tyre;
- 1.2 Menaxhimi efikas i buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore për vitin 2019;
- 1.3 Auditimet dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
- 1.4 Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara;
- 1.5 Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i pasurisë jo-financiare;
- 1.6 Hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore; dhe
- 1.7 Raporti Vjetor për vitin 2018.

Për periudhën TM4/2019 ky objektivi kishte gjithsej tetë (8) nën-aktivitete, të cilat janë realizuar në tërësi.

Megjithatë disa nga aktivitetet kanë të bëjnë me raportimin e rregullt mujor dhe ato aktivitete do të vazhdojnë edhe në periudhat tjera.

Objektiva 2 - Përgatitja e planit strategjik për zhvillim institucional tre (3) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020

Një ndër objektivat më me rëndësi është edhe planifikimi strategjik për zhvillim institucional i cili përbën një segment të veçantë sepse siguron që institucioni ka vizionin dhe orientimet e tij kundrejt qëllimeve të matshme. Si i tillë, planifikimi institucional afatgjatë është një mjet i dobishëm që shërben si udhërrëfyes për vendimmarrje të përditshme dhe gjithashtu për vlerësimin e progresit.

Në kuadër të këtij objekti janë paraparë dy (2) aktivitete të ndërlidhura, si:

- 2.1 Përgatitja e planit strategjik për zhvillim institucional tre (3) vjeçar duke përfshirë vizionin, misionin, vlerat dhe qëllimet strategjike; dhe
- 2.2 Përgatitja e planit vjetor të punës për vitin 2020.

Ky objektivi në kuadër të TM4/2019 ka pasur gjithsej dy (2) nën-aktivitete, nga të cilat një (1) është realizuar, ndërsa një (1) është në proces të realizimit.

Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim / ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe inicimi i tyre për kompletimin e legjislacionit.

Në kuadër të këtij objekti janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 3.1 Dhënia e kontributit në plotësim/ndryshim të legjislacionit ekzistues;
- 3.2 Dhënia e kontributit në hartimin e rregulloreve të reja të cilat janë të nevojshme për plotësimin e legjislacionit sekondar të Fondit; dhe
- 3.3 Krijimi i procedurave të brendshme administrative, përfshirë doracakët për udhëzimin e të punësuarve për punë.

Ky objektivi në kuadër të TM4/2019 ka pasur gjithsej katër (4) nën-aktivitete, nga të cilat një (1) është realizuar, ndërsa tri (3) kanë mbetur të papërfunduara.

Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej katër (4) aktivitete si në vijim:

- 4.1 Ndërlidhja e sistemeve të SISH- Sistemi i Informimit të Fondit;
- 4.2 Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve harduerike;
- 4.3 Menaxhimi, përditësimi, mirëmbajtja dhe migrimi i serverëve dhe pajisjeve të tjera; dhe
- 4.4 Planifikimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të brendshme të Fondit.

Ky objektivi në kuadër të TM4/2019 kishte gjithsej tri (3) nën-aktivitete, të cilat janë realizuar në tërësi.

Objektiva 5 - Implementimi i Sistemit të Informimit të Fondit

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej gjashtë (6) aktivitete si në vijim:

- 5.1 Implementimi i E-recetës;
- 5.2 Doracaku i përdorimit të e-recetës dhe trajnimi i shfrytëzuesve të E-recetës;
- 5.3 Implementimi i SIF-it (Moduli i ndërlidhjes me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), si dhe institucionet tjera relevante;
- 5.4 Implementimi i SIF-it (Moduli për menaxhim të financave dhe kontabilitet);
- 5.5 Implementimi i SIF-it (Moduli i raportimit); dhe
- 5.6 Doracaku i përdorimit të SIF-it dhe trajnimi i shfrytëzuesve të SIF-it.

Ky objektivi në kuadër të TM4/2019 kishte gjithsej katër (4) nën-aktivitete, të cilat janë realizuar në tërësi.

Objektiva 6 - Bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera te kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore

- 6.1 Në kuadër të këtij objektivi është vetëm një (1) aktivitet që ka të bëjë me finalizimin e procedurave për kontraktim dhe definimi modelit të kontratës për shërbime shëndetësore.

Në periudhën e TM4/2019 ky objektivi kishte dy (2) nën-aktivitete, të cilat nuk janë realizuar gjatë këtij tremujori.

Objektiva 7 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej dy (2) aktivitete si në vijim:

- 7.1 Analiza e proceseve të trajtimit mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore; dhe
- 7.2 Barazimi me institucionet shëndetësore private.

Në periudhën e TM4/2019 ky objektivi kishte dy (2) nën-aktivitete, nga të cilat një (1) është realizuar dhe një (1) është në proces të realizimit.

Objektiva 8 - Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 8.1 Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me ATK-në, ARC-në dhe me BQK-në;
- 8.2 Bashkëpunimi me Odat e profesionistëve shëndetësorë; dhe
- 8.3 Bashkëpunimi me donatorët (Donacionet për ofrimin e ndihmës qoftë përmes mjeteve financiare, mbulimin e aktiviteteve ose organizimit të trajnimeve.

Në periudhën e TM3/2019 ky objektivi kishte një (1) nën-aktivitet, i cili nuk është realizuar gjatë këtij tremujori.

Objektiva 9 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 9.1 Zyrrat rajonale;
- 9.2 Rekrutimi i stafit (48 pozita) për plotësimin e pozitave të lira, të nevojshme për funksionalizimin e Institucionit; dhe
- 9.3 Ofrimi i trajnimeve për stafin e ri dhe stafin profesional.

Në periudhën e TM3/2019 ky objektivi kishte tri (3) nën-aktivitete, të cilat janë në proces të realizimit.

Objektiva 10 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premieeve sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor

Në kuadër të këtij objekti janë gjithsej pesë (5) aktivitete si në vijim:

- 10.1 Krijimi i listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për vitin fiskal;
- 10.2 Krijimin e listës së shërbimeve të garantuara nga neni 7 i Ligjit për Sigurime Shëndetësore;
- 10.3 Përcaktimi i çmimeve për çdo shërbim të kujdesit shëndetësor për vitin fiskal;
- 10.4 Përcaktimi i bashkë-pagesave dhe niveleve tjera të bashkëfinancimit për kategoritë e liruara; dhe
- 10.5 Pajisja me kartela të sigurimit, ose mjet tjetër identifikimi për të siguruarit, përfshirë se paku 75% të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, si dhe 75% të individëve të kategorive të liruara.

Në periudhën e TM3/2019 ky objektivi kishte katër (4) nën-aktivitete, nga të cilat dy (2) janë në proces të realizimit, ndërsa dy (2) të tjera kanë mbetur të pa realizuara.

Objektiva 11 - Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguhen nga Fondi

Në kuadër të këtij objekti janë gjithsej katër (4) aktivitete si në vijim:

- 11.1 Inicimi i procedurës për krijimin e bazës ligjore për kontraktimin e barnatoreve;
- 11.2 Finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore më çmime, të cilat do të paguhen nga Fondi;
- 11.3 Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me komuna për përdorimin e E-recetës nga QKMF-të; dhe
- 11.4 Lidhja e kontratave më barnatoret për barnat të cilat do të paguhen nga Fondi.

Në periudhën e TM4/2019 ky objektivi nuk kishte nën-aktivitete, shtyrja e planifikimit të tyre është bërë për shkak të pengesave ligjore që janë hasur në lidhje me kontraktimin e barnatoreve dhe realizimi është shtyrë derisa të qartësohet baza ligjore.

Objektiva 12 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 12.1 Analizë mbi nevojat e informimit, përfshirë grupet e targetuara, metodologjinë e përdorur, etj.;
- 12.2 Përgatitja e materialeve të nevojshme (broshurave, seminareve, spoteve, njoftimeve në faqen elektronike, etj.); dhe
- 12.3 Organizimi i kampanjave informuese.

Në periudhën e TM4/2019 ky objektiv kishte pesë (6) nën-aktivitete. Të gjitha këto aktivitete janë në proces të realizimit.

Objektiva 13 - Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim :


- 13.1 Caktimi i parcelës, përgatitja e projektit ideor si dhe marrja e lejes së ndërtimit;
- 13.2 Procedurat e tenderimit dhe lidhja e kontratës; dhe
- 13.3 Fillimi i ndërtimit të objektit.

Në periudhën e TM4/2019 ky objektiv kishte një (1) nën-aktivitet, i cili nuk kishte arritur të realizohet gjatë këtij tremujori.

Tabela nr. 9. Rezultatet e arritura në TM4 raport me objektivat e përcaktuara

Objektivat	Numri i nën-aktiviteteve të planifikuara për 2019	Numri i nën-aktiviteteve të planifikuara për TM4	Numri i nën-aktiviteteve të realizuara dhe në proces në TM4	Numri i nën-aktiviteteve të pa realizuara në TM4	Shkalla e realizimit të planit të punës 2019 në TM4
Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparenca dhe llogaridhënia në FSSH.	26	8	8	0	100%
Objektiva 2 - Përgatitja e planit për zhvillim institucional tre (3) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020.	7	2	2	0	100%
Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe iniciimi i tyre për kompletimin e legjislacionit.	11	4	1	3	25%
Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve.	19	3	3	0	100%
Objektiva 5 - Implementimi i SIF-it.	21	4	4	0	100%
Objektiva 6 - Bashkëpunimi më Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore.	5	2	0	2	0%
Objektiva 7 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.	4	2	2	0	100%
Objektiva 8 - Ngritja e bashkëpunimit më Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar.	6	1	0	1	0%
Objektiva 9 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional.	6	3	3	0	100%
Objektiva 10 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premive sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor.	21	4	2	2	50%
Objektiva 11 - Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtëspitalore (më çmime) të cilat do të paguhen nga FSSH.	5	0	0	0	0%
Objektiva 12 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.	11	5	5	0	100%
Objektiva 13 - Sigurimi i lokacionit/ fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.	6	1	0	1	0%
Gjithsej	148	39	30	9	77%

